



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Rektoratin e Universitetit “Aleksander Xhuvani” shpall konkurs për pozicionin e punës 1 (një) personel ndihmësakademik me karakter administrativ, me kohë të plotë, Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë,.

Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ, Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë: përgjigjet për mbarëvajtjen e punës në këtë sektor duke koordinuar punën midis specialistëve të sektorit dhe drejtorin; u jep zgjidhje ligjore dhe teknike problemeve brenda sektorit duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë drejtorisë; zgjidh mosmarrëveshjet në lidhje me kompetencat për ndjekjen e problemeve duke bashkëvepruar me drejtorin e drejtorisë; raporton tek drejtori, harton raporte, kryen analiza periodike si dhe me përpikmëri e nivel të lartë përgjegjshmërie brenda afateve detyrat që i ngarkohen,

### **Kritere të përgjithshme:**

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master i Shkencave) në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare ose diplomë ekuivalente me të.
- Të ketë përvojë pune.
- Të ketë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vërtetuar me dokumentacion.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë.

### **Kritere të veçanta:**

- Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite punë në fushën e kërkuar.
- Të ketë përvojë pune në IAL
- Të ketë kualifikime në fushën e marrëdhënieve me jashtë brenda e jashtë vendit.
- Të jetë njohës dhe përdorues i programeve bazë kompjuterike.
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**24.01.2022 - 02.02.2022**) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

- Letër motivimi për pozicionin e punës *Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë*, në Drejtorinë e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (24.01.2022 - 02.02.2022) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyma”,**

**Aplikim për pozicionin e punës: *Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë*  
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Rektoratit**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (04.02.2022 – 16.02.2022). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.